

## STATUTI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“ R.N.M“ SH.P.K

#### KREU I

**Emërtimi, Objekti, Kohëzgjatja, Selia, Forma Juridike**

#### Neni 1

##### Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, person juridik i të drejtës shqiptare, është “R.N.M” sh.p.k dhe me emer tregtar: R.N.M sh.p.k

#### Neni 2

##### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Tregti me pakice te artikujve higjenosanitare, elektrike, hidraulike, materiale ndertimi dhe artikuj te ndryshem. Pjese kembimi dhe automjete te perdonura. Organizim eventesh dhe festash te ndryshme. Sherbim hoteli, restoranti, bari. Prodhim dhe tregtim peme frutore, dekorative, lule, vazo, pleh organik dhe kimik. Prodhim dhe tregtim i farerave dhe fidaneve. Materiale dezinfektimi, deratizimi, dezinsektikim, material pastrimi. Materiale didaktike mesimore, axhusterie etj. Prodhim dhe tregtim i materialeve restauruese, konservuese dhe i solucioneve te veprave te artit dhe monumenteve historike. Sherbime mirembajtje, nderrim pjesesh te motogeneratorit. Blerje ene kuzhine dhe pajisje te tjera. Pastrim i i kanaleve te ujrale te bardha dhe te zeza, pastrami i puseve te ujit etj. Tregtim, kolaudim dhe rimbushje i mjeteve te mbrojtjes kundra zjarrit. Ofrimi i sherbimeve grafike dhe prodhime te ndryshme. Prodhim dhe tregtim i uniformave, veshjeve dhe pajisjeve te buta per spitale, polici, kulinari etj. Pajisje elektronike hardweri TIK. Perpunim druri, duralumini, metali, plastike. Tregti dhe sherbime me bojra, llak dhe solucione te ndryshme. Blerje artikuj sportive dhe gjimnastikore. Tregtim me pakice dhe shumice te gomave te reja, bateri, produkteve industriale dhe ushqimore. Prodhim, tregtim, montim, eksport reklamash, materiale elektrike, hidraulike dhe mekanike. Tregtimmakinash te perdonura dhe pjese kembimi. Tregti libri, kancelari, materiale pastrimi. Prodhim, punime, tregtim duralumini, punime druri dhe plastike, punime etalbont, fasada xhami etj. Tregtim, import-eksport te pijeve alkoolike, mallrave ushqimore. Sherbime portuale, riparime, mirembajtje te mjeteve portuale. Lyerje te te gjitha llojeve. Sherbime postare, nderkombetare, shitje biletash trageti, avioni dhe autobusi. Sherbime automjetesh me arrotrec. Furnizim me uje si dhe pastrim i mbeturinave ne zonat portuale dhe te mjeteve detare. Dekor, ndricim dhe sinjalizim urban. Prodhime bujqesore, blegtorale dhe rritje kafshesh. Pastrim



dhe mirembajtje pyjesh, kullotash, mbjellje pemesh, dru frutore, peme dekoratike, peme te ndryshme pyjore. Ndertim dhe rikonstruksione te ndryshme. Transport mallrash dhe Sherbim transporti brenda dhe jashte vendit, taksi, mikrobuze, autobuze tj. Transport nderkombetare udhetares, agjent per trasferimin e parave ne emer dhe per llogari te nje subjekti jo-banke, Tregtim atrikuj promocional. Agjensi Imobililiare. Automjete me qera. Pllaka dhe pajisje hidraulike, hidrosanitare e termosanitare. Mallra industrial te lendeve te para e materialve te mdertimit si dhe makineri ndertimi e pjese kembimi per to. Servise per automjete te llojeve dhe tonazheve te ndryshme. Grumbullim dhe shitje skrapi. Agjensi doganore. Transport mallrash brenda dhe jashte vendit. Autoshkoll. Sherbime Interneti. Tregtim dyshekesh, batanie, jasteke, mbulesa dhe çarçafe, kozmetike dhe materiale parukerie, elektroshtepiak. Tregtim dhe montim kondicioneresh. Sherbim mirembajtje dhe tregeti e paisjeve mjekesore.

### Neni 3

#### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

### Neni 4

#### Selia

(1) Shoqëria e ka selinë në adresën: Njesia Administrative Shupenze banesa nr 11, Rruga Nationale Peshkopi -Bulqize

(2) Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, Brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 5

#### Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë dhe është i përbërë nga 1 kuote.

(2) Pjesëmarrja Z.Milaim Drizi shtetas Shqiptar, lindur në Sine e Eperme Dibër, më 17/01/1988, mbajtës i pasaportes nr.BJ1793046 si ortak i vetem në kapitalin e shoqërisë është për gjithë kapitalin themeltar të shoqërisë në vlerën e 100.000 lekëve të përbërë nga 1 kuotë.

(3) Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.



(4) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyre, pasuri të luajtshme e të paluajtshme.

(5) Ortaku, që pengohet të ushتروجë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cënimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cënimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cënimit.

(6) Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për të vërtetuar zotërimin e kuotës së kapitalit.

(7) Ortakët e shoqërisë përgjigjen për detyrimet kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e saj.

## Neni 6

### Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

(1) Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

(2) Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

(3) Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të tretëve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së kualifikuar që kërkon ndryshimi i statutit.

(4) Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

(5) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

(6) Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## Neni 7

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

(1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

##### Organı Vendimmarrës

(1) Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

(2) Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori (-ët), përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

(3) Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

(4) Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose nëpërmjet postës elektronike (e-mail). Njoftimi me shkressë apo me postë elektronike duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

(2) Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kuorumi

(1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

(2) Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 1/2 (gjysmën) e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

(3) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendor më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

(1) Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  (tri të katërtat) e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

(2) Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimi i shpërblimeve;
- d) mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- f) miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- g) çështje të tjera të miratuara nga ligji apo statuti;

(3) Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### Administrimi

(1) Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

(2) Personi përgjegjës për administrimin dhe përfaqësimin e shoqërisë është Z.Milaim Drizi, shtetas shqiptar, lindur në Sine e Eperme Diber, më 17/01/1988, mbajtës i pasaportes nr. BJ1793046 , Kompetencat e përfaqësimit janë të plota duke i dhënë tagër përfaqësuesit të përfaqësojë shoqërinë në të gjitha marrëdhëni të juridike apo veprimet juridike, në të cilat shfaqet shoqëria .



(3) Administratori do të ushtrojë detyrat e tij sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

(4) Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Q.K.B.

(5) Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

(6) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

(7) Administratori mund t'u delegojë personave të tretë të caktuar prej tij, një pjesë apo të gjitha kompetencat e tij, me anë të një prokure e cila është objekt aprovimi nga Asambleja e Ortakëve me shumicë prej 60 %. E njëjtë procedurë ndiqet edhe për revokimin e kësaj prokure.

## Neni 13

### Kompetencat

(1) Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël ;

ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryen regjistrimet, i dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

(2) Administratori është i detyruar të thërrasë asamblenë e përgjithshme edhe kur:



- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim;
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

(3) Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.

(4) Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridikë, publikë dhe/ose privatë vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve.

(5) Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

(6) Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

(7) Shoqëria nuk merr përsipër pasojet ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i Administratorit/ëve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## Neni 14

### Përgjegjësitë

(1) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

(2) Pasojet e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojet përkatëse.

(3) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi,
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë konfliktin, e interesave personale me ato të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuaara.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

5. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

6. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financier, nëse është e nevojshme.

7. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë-padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Administratori mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Ortakëve, të aprovuar nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë 60% të kapitalit të shoqërisë.

Gjithashtu, Administratori mund të shkarkohet në çdo moment me vendim të autoritetit gjyqësor shqiptar, për shkelje të ligjit.



## Neni 15

### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

## Neni 16

### Bilanci i shoqërisë dhe dividendët

(1) Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

(2) Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime ortakëve, vetëm nëse pas pagimit të dividendit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

(3) Administratori lëshon një çertifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përbush kërkeshat e paragrafit 2 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përbush këto kritere, administratori nuk mund ta lëshojë këtë çertifikatë.

(4) Pas plotësimit të parashikimeve të paragrafit 2 të këtij neni, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në raport me kuotat e zotëruara.

## Neni 17

### Ekspertët

(1) Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

(2) Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar.

## Neni 18



## **Shpërndarja ose prishja e shoqërisë**

(1) Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 për " Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim të gjykatës;

(2) Në këtë rast, Ortakët marrin vendim me shkrim, parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar likuidator dhe shënon në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuiduesit dhe emërtesën shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër".

(3) Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

(4) Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë nenet 191 deri në 203 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

(5) Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## **Neni 19**

### **Baza Ligjore**

(1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në R.Sh.

## **Neni 20**

### **Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jenë kompetente gjykatat shqiptare, sipas rregullave të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

**Dispozita e fundit**

- (1) Ky statut hyn në fuqi me regjistrimin e tij pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit.
- (2) Ky statut u redaktua në 3 ekzemplarë me përbajtje dhe vlerë të njëjtë juridike, në gjuhën shqipe miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortakët themelues të shoqërisë tregtare dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet.

Miratuar me datë 26/10/2020

**ORTAKU**

I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

“R.N.M” sh.p.k.

Milaim Drizi

*Milaim DRIZI*  
*[Signature]*

*26/10/2020*

*[Signature]*